



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS**

Nr. ____ prot

Kukës, me 03.09.2014.

R R E G U L L O R E

**MBI NDALIMIN E PIRJES SË DUHANIT NË AMBIENTET E INSTITUCIONIT TË
PREFEKTURËS SË QARKUT KUKËS**

Bazuar në ligjin nr 8927 dt 25.07.2002 “Për Prefektin”neni 6 pika (a) neni 18 pika (1),ligjin 9636 dt.06.11.2002 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”neni 15 i ndryshuar,si dhe të shkresës së Ministrisë së Brendshme me nr 3865 prot dt 28.08.2014 ,duke marrë parasysh pasojat e dëmshme që sjell pirja e duhanit për shëndetin e njeriut sidomos konsumuesit pasiv si dhe mbrojtjen e mbajtjen pastër të ambienteve të punës brenda Institucionit hartohet:

“Rregullorja e ndalimit të pirjes së duhanit në ambientet e Institucionit të Prefekturës“:

N E N I - 1

Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në ambientet e brendshme të Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës gjatë orarit të punës së administratës në Institucion.Pirja e duhanit lejohet vetëm jashtë ndërtesës së Institucionit.

N E N I - 2

Të vendosen në vende të dukshme postera me logon e ndalimit të pirjes së duhanit dhe të tregohet kujdes në mirmbajtjen e tyre nga punonjësit e shërbimit dhe të pastrimit.

N E N I - 3

Të njihen të gjithë punonjësit e Administratës së Institucionit të Prefektit me këtë rregullore dhe të kërkohet nga ta zbatimi korrekt i neneve të saj duke ju bërë të qartë edhe penalitetet për kundravajtësit e kësaj rregulloreje.

N E N I - 4

Personat që konstatohen se shkelin këtë rregullore duke përdorur duhan në ambientet e Institucionit brenda orarit të punës paralajmërohen me “Vërejtje” deri me gjobë në masën 5% të pagës neto të punonjësit.

N E N I - 5

Personi përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës.

N E N I - 6

Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga ana e Prefektit të Qarkut Kukës.

P R E F E K T I

Safet GJICI